

Muhammed Asad

*Shpirti
i
Islamit*



Future's Youth Publications
2005

Muhamed ASAD

Titulli i librit në anglisht: "The Spirit of Islam"

ISBN 99927-917-1-3

Shqipëroi: Ermal BEGA

Redaktor dhe korrektor: Muhamed ELIFI

Radhitja kompjuterike: Ermal BEGA

Kopertina: R.E.S.A

Faqosja: Ilir HOTI

Botimi i parë anglisht, 1979/1399 H

Botimi i dytë anglisht, 1980/1400 H

Rishtypur në anglisht, 1984

Botimi i parë në shqip, 2005

© Organizata kulturore "Rinia e së Ardhmes", Tiranë 2005

Shtypur në Shqipëri - Printed in Albania

COPYRIGHT

Parathënia e botimit të ri

Ne ndiejmë një kënaqësi të madhe në sjelljen e një botimi të ri të kësaj broshure në vështimin e kërkimit të vazhdueshëm të përpjekjeve të shkurtëra mbi aspekte të ndryshme të Islamit. Kjo broshurë është botuar për herë të parë katër vite më parë (1979) nga Këshilli Islam i Evropës, i marrë nga një libër mbi Islamin - Islami: Kuptimi dhe Mesazhi i tij, i botuar nga vëllai Khushid Ahmed, tani kryetar i Fondacionit Musliman. Përmasa e tij e përshtatshme e bëri atë një shtesë jashtëzakonisht të nevojshme në rritjen e literaturës mbi Islamin, duke e pajisur lexuesin e zënë modern me një trajtim të dobishëm në një aspekt të veçantë të Islamit në stilin e qartë dhe bindës të një autori të mirënjohur.

Meqenëse botimi i parë përfundoi së shituri, dhe meqenëse ne vazhduam të presim interesime dhe kërkesa nga vende të ndryshme, ne vendosëm të publikojmë një botim të dytë. Zhvillimet e fundit në skenën botërore kanë nënvizuar rëndësinë vendimtare të Islamit në territoret strategjike jetësore. Ne duhet të nënvizojmë ashpër nevojën e vërtetë për informacion më të plotë rreth asaj se: çfarë ka më shumë rëndësi është ajo se informacioni i siguruar duhet të jetë njëkohësisht i saktë dhe objektiv, duke e paraqitur Islamin ashtu siç është në të vërtetë. Asgjë më e paktë mund të krijojë respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë ndërmjet muslimanëve dhe jo-muslimanëve, aq mirë sa të ripërtëriturit e ndërgjegjësimit të vetë muslimanëve. Ne besojmë se këto broshura dhe të njëjta me to kontribuojnë së tepërmi në këtë drejtim.

Ne i lutemi Allahut që të bekojë përpjekjet tona me mëshirën dhe pëlqimin e Tij.

Islamic Foundation (Fondacioni Islam)
Leicester
18 Tetor 1979
25 Dhulkade 1399

KHURRAM JAN MURAD
Drejtor i Përgjithshëm

COPYRIGHT



You have either reached a page that is unavailable for viewing or reached your viewing limit for this book.



You have either reached a page that is unavailable for viewing or reached your viewing limit for this book.



You have either reached a page that is unavailable for viewing or reached your viewing limit for this book.



You have either reached a page that is unavailable for viewing or reached your viewing limit for this book.



You have either reached a page that is unavailable for viewing or reached your viewing limit for this book.



You have either reached a page that is unavailable for viewing or reached your viewing limit for this book.



You have either reached a page that is unavailable for viewing or reached your viewing limit for this book.



You have either reached a page that is unavailable for viewing or reached your viewing limit for this book.

Prej të gjitha feve, vetëm Islami e bën atë të mundshme për njeriun që të shijojë vargun e plotë të jetës së tij tokësore, pa humbur për një moment orientimin e tij shpirtëror. Sa tërësisht e ndryshme është kjo nga koncepti i krishterë! Sipas besimit të krishterë, njerëzimi u pengua në një gabim të trashëguar nga Adami dhe Eva (Ademi dhe Hava), dhe si pasojë e tërë jeta u vështrua – të paktën sipas teorisë dogmatike – si një luginë e errët e hidhërimeve. Ajo është fushë beteja e dy forcave të kundërta: e keqja, e shprehur nga shejtani, dhe e mira, e paraqitur nga Jezu Krishti. Shejtani përpiqet, me anë të tundimeve fizike, që të pengojë progresin e shpirtit të njeriut drejt dritës së përjetshme; shpirti i përket Krishtit, ndërsa trupi është parku i lojërave të ndikimeve të djallit. Një gjë mund ta shprehë atë ndryshe: bota e Materies (materiale) është tërësisht satanike, ndërsa bota e Shpirtit është hyjnore dhe e mirë. Çdo gjë në natyrën njerëzore që është materiale, ose ‘trupore-fizike’, sic preferojnë ta quajnë të krishterët, është një përfundim i drejtëpërdrejtë i dhënies së Adamit ndaj këshillave të princit djallëzor të errësirës dhe materiales. Prandaj, për të arritur shpëtimin, njeriu duhet ta largojë zemrën e tij nga kjo botë e trupit drejt së ardhmes, botës shpirtërore, ku ‘mëkati i njerëzimit’ është shlyer nga sakrificimi i Krishtit në kryq.

Edhe kjo dogmë nuk është - dhe nuk ka qenë kurrë - e zbatuar në praktikë, ekzistimi i një mësimi të tillë priret që të shkaktojë një ndjenjë të vazhdueshme të ndërgjegjes së keqe në njeriun me prirje fetare. Ai është lëkundur ndërmjet thirrjes së prerë që të braktisë botën dhe dëshirës natyrale të zemrës së tij për të jetuar dhe shijuar këtë jetë. Mendimi i vetëm i pashmangshëm, sepse është mëkat i trashëguar, dhe e enigmave të tij - në intelektin mesatar të pakuptueshëm - shlyerje përmes vuajtjes së Jezusit në kryq, ngre një pengesë mes dëshirës së madhe shpirtërore të njeriut dhe dëshirës së tij ligjore për të jetuar.

Në Islam, ne nuk njohim asgjë për Gabimin e Parë; ne e vështrojmë atë si mospërputhje me idenë e drejtësisë së Zotit; Zoti nuk e bën fëmijën të përgjegjshëm për veprimet e babait të tij; dhe si ka mundësi që Ai ka bërë gjithë ato gjenerata të pafund të njerëzimit përgjegjës për një mëkat të mosbindjes të kryer nga një stërgjysh i largët? Është pa dyshim e mundur që të formohen shpjegime filozofike të këtij supozimi të çuditshëm, por për mendjen e thjeshtë ajo do të mbesë gjithmonë si artificiale, dhe si e papranueshme sikurse koncepti i vetë Trinisë. Dhe meqë nuk ka mëkat të trashëguar, gjithashtu nuk ka shlyerje universale të njerëzimit në mësimet e Islamit. Shlyerja dhe dënimi janë individuale. Çdo musliman është vetë shpengues; ai mbart të gjitha mundësitë e suksesit shpirtëror dhe dështon brenda vetes së tij. Në Kur'an për personalitetin njerëzor thuhet:

“Secili merr shpërblim për atë (të mirë) që ka fituar dhe (po kështu) secili merr dënim për atë (të keqe) që ka fituar.” (Kur'an, 2:286)

Një ajet tjetër thotë:

“Dhe njeriu s'mund të ketë tjetër veçse atë që ai bën (të mirë ose të keqe).” (Kur'an, 53:39)

Kjo është një arsye morale e veprimtarisë së shëndetshme të Islamit, një arsye e nënshtrimeve të hershme islame. Ajo e ka kuptimin, siç e ka edhe sot, ndërtimin e një kornize tokësore, për zhvillimin më të mirë shpirtëror të mundshëm të njeriut. Sepse, sipas mësimave të Islamit, njohuria morale e forcon automatikisht përgjegjësinë morale tek njeriu. Një dallim i dukshëm platonik i të Drejtës dhe të Gabuarës, pa nxitjen për të përkrahur të Drejtën dhe për të shkatërruar të Gabuarën, është një imoralitet i madh në vetvete. Në Islam, morali jeton dhe vdes me përpjekjen njerëzore për të vendosur fitoren e tij në tokë.

COPYRIGHT